



Instituti i Kosovës për Drejtësi

**Analizë e shkurtë:
Nr. 04/2016 - IKD**

VENDIMET E KUNDËRLIGJSHME TË KPK-SË DHE PRAKTIKAT E KËQIJA TË NDRYSHIMIT TË RREGULLOREVE NGA KGJK

Prishtinë, dhjetor 2016

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Hyrja 1, Kati 1, Nr. 1
Rr. Rustem Statovci
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

përkrahur nga:



British Embassy
Pristina

Dhjetor 2016
Prishtinë, Republika e Kosovës

PËRMBAJTJA:

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
II. VENDIMI I KUNDËRLIGJSHËM I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS.....	6
Rekomandim.....	9
III. KGJK NDRYSHON RREGULLOREN NË MES TË PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES, I JEP TË DREJTË VOTE EDHE ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË CAKTUAR PËR EMËRIMIN E KRYETARËVE DHE MBIQYRËSVE TË GJYKATAVE	11
Rekomandim.....	12

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) gjatë monitorimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), ka gjetur se edhe gjatë muajit dhjetor të vitit 2016, të dy Këshillat gjatë ushtrimit të funksioneve dhe veprimtarive të tyre, kanë marr vendime që bien në kundërshtim me ligjet bazike që rregullojnë sistemin prokurorial dhe vendime që ndërtojnë praktika të këqija lidhur me procesin e emërimit të Kryetarëve të Gjykatave apo Gjykatësve Mbikëqyrës.

KPK më 2 dhjetor 2016 ka miratuar vendimin nr. 1485/2016, mbi vazhdimin e transferimit të përkohshëm të prokurorit Abdurrahim Islami. I njëjti Këshill më 27 maj 2016, kishte marr vendim për transferim të përkohshëm të prokurorit Islami nga Prokuroria Themelore në Prishtinë në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK).

Paraprakisht, Kryeprokurori i Shtetit, z. Aleksandër Lumezi më 18 prill 2016, me Vendim kishte transferuar të njëjtin nga Prokuroria Themelore në Prishtinë në PSRK, duke shfrytëzuar nenin 22 paragrafin 3 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, i cili në raste të jashtëzakonshme, i mundëson Kryeprokurorit të Shtetit përkohësisht të transferojë një prokuror në një prokurori tjetër. Transferim i ndërmarrë sipas kësaj dispozite nuk mund të tejkalojë tridhjetë (30) ditë përveç nëse Këshilli miraton një periudhë më të gjatë.

Transferimi i prokurorit Islami sipas Vendimit të Kryeprokurorit të Shtetit kishte shkelur afatin ligjor prej 30 ditëve. Me vendim të Kryeprokurorit të Shtetit, prokurori Islami ka qëndruar 44 ditë, respektivisht nga data 18 prill 2016 deri më 31 maj 2016.

Po ashtu vendimet e KPK-së të datës 27 maj 2016 dhe 2 dhjetor 2016, janë miratuar në kundërshtim me Ligjin për KPK-në dhe Rregulloren për Transferim dhe Avancim të Prokurorëve të Shtetit. Ligji për KPK-në në nenin 22 përcakton taksativisht se ndalon transferimin e të njëjtit prokuror në një prokurori tjetër për një periudhë kohore më të gjatë se gjashtë (6) muaj për një herë. Prokurori Islami, me dy vendime të KPK-së, tanimë i është vazhduar transferimi i përkohshëm në PSRK për herë të dytë.

Vendimet e KPK-së, po ashtu bien në kundërshtim edhe me nenin 2 të Rregullores për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, pasi që kalimi nga Prokuroria Themelore në Prishtinë si prokurori e nivelit më të ultë në PSRK si prokurori e specializuar dhe e nivelit më të lartë, konsiderohet avancim dhe jo transferim siç ka vendosur KPK me dy vendimet saj të muajit maj dhe dhjetor 2016. Sipas rregullave dhe procedurave të miratuara nga KPK, avancimi i prokurorëve duhet të kalojë vetëm përmes institutit të konkursit, që në rastin konkret ky parim është shkelur nga vet KPK.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) më datë 8 dhjetor 2016, ka marr Vendim për miratimin e Rregullores Nr. 17/2016 për ndryshimin e Rregullores Nr. 14/2016, për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 09/2016 për Procedurat e Zgjedhjes, Emërimit, Vlerësimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës.

KGJK përmes kësaj rregullore ka ndryshuar Procedurat e Zgjedhjes, Emërimit, Vlerësimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës. Sipas këtij Vendimi, iu është lejuar anëtarëve të Komisionit Vlerësues përveç të marrin pjesë në takimin e KGJK-së kur merret vendim për emërimin e Kryetarëve apo Gjykatësve Mbikëqyrës, të njëjtit të kenë edhe të drejtën për të votuar.

KGJK tanimë e ka shndërruar në praktik plotësimin dhe ndryshimin e rregullave dhe procedurave lidhur me procese të rëndësishme në sistemin gjyqësor. KGJK të njëjtin qasje kishte zbatuar edhe gjatë procesit të emërimit të gjykatësve të rinj.



ANALIZË LIGJORE E VENDIMIT
TË KËSHILLIT PROKURORIAL
TË KOSOVËS NR. 471/2016
(02.12.2016)

II. VENDIMI I KUNDËRLIGJSHËM I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) më datë 2 dhjetor 2016, ka mbajtur takim të jashtëzakonshëm të thirrur nga Kryesuesi i KPK-së, z. Blerim Isufaj dhe Kryeprokurori i Shtetit, z. Aleksandër Lumezi.

Këshilli në këtë takim ka diskutuar dhe vendosur vetëm për një pikë të rendit të ditës: *“Shqyrtimin e vazhdimit të transferimit të prokurorit Abdurrahim Islami në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK)”*.

KPK sipas rendit të ditës ka marr Vendim për vazhdimin e transferimit të prokurorit Abdurrahim Islami në PRSK, për herë të dytë edhe për gjashtë (6) muaj, respektivisht deri më 31 maj 2017.¹

Vendimi i KPK-së është në kundërshtim me Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Rregulloren e miratuar nga KPK lidhur me transferimin dhe Avansimin e Prokurorëve të Shtetit.

KPK vetëm dy ditë më herët, më 30 nëntor 2016, kishte mbajtur takimin e 124, ku ishin miratuar një varg vendimesh.² Është e çuditshme se si në këtë takim nuk ishte në rend të ditës çështja e prokurorit Islami, edhe përkundër faktit se po në të njëjtën ditë më 30 nëntor 2016, të njëjtit i kishte skaduar mandati për të ushtruar funksionin e prokurorit në PSRK, sipas vendimit të KPK-së.

Një qasje e tillë vë në pah dështimin e sistemit prokurorial, duke filluar nga Sekretariati, Njësi të për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorëve, PSRK, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe KPK, për të zbatuar vendimet e miratuara në Këshill dhe monitorimin e zbatimit të tyre në praktikë.

Për më tepër vendimi i KPK-së lidhur me vazhdimin e transferimit të prokurorit Islami është i kundërligjshëm. Një vendim i tillë bie në kundërshtim me Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës, respektivisht me nenin 22 paragrafin 1 të këtij ligji i përcakton se:

“Me paraqitjen e kërkesës nga Kryeprokurori, Këshilli mund të transferojë një prokuror në një prokurori tjetër për një periudhë kohore jo më të gjatë se gjashtë (6) muaj për një herë.”

¹ “Është mbajtur takimi i radhës i Këshillit Prokurorial të Kosovës”. Njoftimi i Këshillit Prokurorial të Kosovës. 2 dhjetor 2016 (shih linkun : http://www.kpk-rks.org/single_lajmi/1180/sht-mbajtur-takimi-i-) (qasur për herë të fundit me 2 dhjetor 2016). Vendimi i KPK/Nr.471/2016. 02 dhjetor 2016.

² “Është mbajtur takimi i radhës i Këshillit Prokurorial të Kosovës”. Njoftimi i Këshillit Prokurorial të Kosovës. 30 nëntor 2016 (shih linkun http://www.kpk-rks.org/single_lajmi/1175/-sht-mbajtur-takimi-i-radhs-i-kshillit-prokurorial) (qasur për herë të fundit me 2 dhjetor 2016).

Prokurori Abdurrahim Islami ishte transferuar nga Departamenti për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Prishtinë në PSRK, me Vendim të Kryeprokurorit të Shtetit, z. Aleksandër Lumezi më 18 prill 2016 deri më 31 maj 2016.³

Vendimi i Kryeprokurorit të Shtetit, z. Aleksandër Lumezi për transferimin e prokurorit Islami në Prokurorinë Speciale ishte marr në kundërshtim me nenin 22 paragrafin 3 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, i cili përcakton se:

“Për raste të jashtëzakonshme, Kryeprokurori i Shtetit mundet përkohësisht të transferojë një prokuror në një prokurori tjetër. Transferim i ndërmarrë sipas kësaj dispozite nuk mund të tejkalojë tridhjetë (30) ditë përveç nëse Këshilli miraton një periudhë më të gjatë.”

Vendimi i Kryeprokurorit të Shtetit për transferimin e z. Islami ka shkelur nenin 22 paragrafin 3 të Ligjit për KPK-në, i cili përcakton në mënyrë obliguese se transferimi i një prokurori nga një prokurori në prokurorinë tjetër në bazë të kësaj dispozite nuk mund të kaloj tridhjetë (30) ditë, përveç nëse Këshilli miraton një periudhë më të gjatë. Qëndrimi i prokurorit Islami sipas transferimit me Vendim të Kryeprokurorit të Shtetit ka tejkaluar afatin prej tridhjetë (30) ditëve, duke qëndruar katër dhjetë e katër (44) ditë, apo 14 ditë jashtë afatit ligjor të përcaktuar me ligj.

Pas vendimit të Kryeprokurorit të Shtetit për transferimin e prokurorit Islami në PSRK, KPK me datë 27 maj 2016, me vendim⁴ e kishte transferuar të njëjtin prokuror përkohësisht në PSRK nga Prokuroria Themelore në Prishtinë. Vendimi kishte përcaktuar se prokurori Islami transferohet në PSRK nga 1 qershori 2016 deri më 31 nëntor 2016. Karakteristikë e këtij vendimi është fakti se evidentohet një datë e pashënuar në kalendar, pasi shkruhet data 31 nëntor, e cila datë nuk figuron në muajin nëntor, pasi ky muaj numëron 30 ditë.

Vendimi i KPK-së i datës 27 maj 2016, mbi transferimin e përkohshëm të prokurorit Islami në PSRK, ishte bazuar në nenin 22 të Ligjit⁵ për KPK-në dhe nenit 7 të Rregullores⁶ për Transferim dhe Avancim të Prokurorëve të Shtetit.

KPK përsëri më datë 2 dhjetor 2016, në mbledhjen e jashtëzakonshme të thirrur nga Kryesuesi i KPK-së dhe Kryeprokurori i Shtetit, ka marr vendim për të transferuar prokurorin Islami në PSRK edhe për gjashtë muaj shtesë, respektivisht deri më datë 31 maj 2017.

Ky vendim i KPK-së, shkel në mënyrë të drejtpërdrejtë nenin 22 paragrafin 1 të Ligjit për KPK-në, i cili ndalon transferimin e të njëjtit prokuror në një prokurori tjetër për një periudhë kohore **më të gjatë se gjashtë (6) muaj për një herë**. KPK gjatë të njëjtit vit ka marr dy vendime për

³ Arsyetimi i Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Nr. 190/2016, i datës 27 maj 2016, në: http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.676.2016_Vendim_-_Abdurrahim_Islami_Prokuror_ne_PTH_-_Prishtine_-_Transferohet_ne_PSRK_nga_1_qershori_der_i_me_31_nentore_2016_-_KPK_.pdf, (qasur për herë të fundit me 2 dhjetor 2016).

⁴ Po aty 2.

⁵ Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës. (shih linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2709>) (qasur për herë të fundit me 2 dhjetor 2016).

⁶ Faqja zyrtare e Këshillit Prokurorial të Kosovës. (shih linkun <http://www.kpk-rks.org/legjislacionii/196/rregulloret-2016/196>) (qasur për herë të fundit me 2 dhjetor 2016).

transferimin e prokurorit Islami në PSRK, një më datë 27 maj 2016 dhe një më datë 2 dhjetor 2016. Me vendimin e datës 2 dhjetor 2016, Këshilli ka tejkalluar afatin ligjor të përcaktuar me Ligjin për KPK-në prej gjashtë muajsh.

Vendimet e KPK-së për transferimin e prokurorit Islami nga Prokuroria Themelore në Prishtinë në PSRK, po ashtu bien në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Rregulloren e miratuar nga KPK lidhur me transferimin dhe avancimin e prokurorëve të shtetit. KPK këtë rregullore e kishte miratuar më 31 mars 2016, apo para vendimit për transferimin e parë të prokurorit Islami më datë 27 maj 2016.

Rregullorja për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit përcakton procedurat dhe kriteret e transferimit të prokurorëve të shtetit. Po ashtu, kjo rregullore në nenin 2 përkufizon dhe bën dallimin në mes të transferimit dhe avancimit të prokurorëve.

Kjo rregullore ka përcaktuar se transferimi mund të jetë i përkohshëm dhe i përhershëm, si më poshtë:

Transferimi i përkohshëm nënkupton transferimin e një prokurori me afat të caktuar.

Transferimi i përhershëm nënkupton transferimin e një prokurori nga një Prokurori Themelore në një tjetër Prokurori Themelore ose nga një Departament në Departament tjetër të nivelit të njëjtë dhe me kushte të njëjta. Transferimi nënkupton edhe transferimin në Departament të nivelit më të ulët me kërkesë të vet prokurorit.

Kjo rregullore po ashtu përcaktuar përkufizimin e avancimit të prokurorëve. Sipas kësaj rregullore në nenin dy, me avancim nënkuptohet ngritja në detyrë e një prokurori nga një prokurori e nivelit më të ultë në atë të nivelit më të lartë.

Vendimi i KPK-së bie në kundërshtim edhe me nenin 2 të Rregullores për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, pasi që kalimi nga Prokuroria Themelore në Prishtinë si prokurori e nivelit më të ultë në PSRK si prokurori e specializuar dhe e nivelit më të lartë, konsiderohet avancim dhe jo transferim si ka vendosur KPK me dy vendimet saj të muajit maj dhe dhjetor 2016.

Për më tepër, avancimi i prokurorit Islami nga Prokuroria Themelore në Prishtinë në PSRK, bie në kundërshtim edhe me nenin 3 të Rregullores, e cila i përcakton parimet themelore mbi të cilat duhet të udhëhiqet KPK gjatë procesit të transferimit dhe avancimit të prokurorëve.

Ky nen përcakton se zhvillimi në karrierë i prokurorëve, avancimi dhe transferimi i tyre duhet të bazohet në kriteret objektive siç janë: aftësitë profesionale, merita dhe përvoja profesionale, si dhe zhvillimi në karrierë, avancimi dhe transferimi duhet të bazohen vetëm sipas ligjit dhe kësaj rregullore dhe me pëlqimin e prokurorëve.

Nga kriteret dhe procedurat ligjore të lartpërmendura, KPK është mjaftuar vetëm me plotësimin e një kriteri, pëlqimin e prokurorit Islami, duke anashkalluar dhe shkelur kriteret ligjore.

Vendimet e KPK-së po ashtu kanë shkelur një varg të neneve të Rregullores për Transferim dhe Avancim të Prokurorëve, rregullore kjo e miratuar nga vet KPK, si neni 4 (Shpallja e brendshme për Transferim dhe Avancim të Prokurorëve), neni 7 (Transferimi i përkohshëm dhe transferimi sipas detyrës zyrtare), neni 8 (Avancimi i prokurorëve) si dhe nenet 9, 10, 11, 13, 14, 15 16 dhe 17 të Rregullores.

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) vlerëson nevojën e KPK-së për plotësimin e pozitave të lejuara për prokurorë në PSRK. IKD në mënyrë të vazhdueshme ka kërkuar nga KPK që të plotësoj pozitën e lira për prokurorë, ku nga 18 pozita të lejuara për prokurorë në prokurori, janë të plotësuara vetëm 8.

Sidoqoftë, IKD pret nga KPK që gjatë procesit të plotësimit të këtyre pozitave, të zbaton strikt Ligjin për KPK-në, Ligjin për Prokurorin e Shtetit, rregulloret dhe aktet e brendshme të miratuara nga vet Këshilli.

Praktika e instaluar nga KPK, lidhur me shkeljen e ligjit dhe akteve të brendshme gjatë ushtrimit të funksioneve dhe përgjegjësisë të tij, përmes miratimit të Vendimeve të kundërligjshme zbehë edhe më tej besimin e publikut, qytetarëve dhe sistemit prokurorial për të ndërtuar një sistem të paanshëm, të drejtë, të pavarur dhe profesional.

Rekomandim

IKD i rekomandon KPK-së, që të ri vlerësoj Vendimin e datës 2 dhjetor 2016, dhe të marr vendim të bazuar në ligj dhe aktet e brendshme të vet Këshillit.



ANALIZË LIGJORE E PRAKTIKËS
SË NDRYSHIMIT TË SHPESHTË
TË RREGULLOREVE NGA
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS

III. KGJK NDRYSHON RREGULLOREN NË MES TË PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES, I JEP TË DREJTË VOTE EDHE ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË CAKTUAR PËR EMËRIMIN E KRYETARËVE DHE MBIKQYRËSVE TË GJYKATAVE

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) më datë 8 dhjetor 2016, ka mbajtur takimin e 168, ku janë marr një sërë vendimesh. Në këtë takim KGJK ka marr Vendim për miratimin e Rregullores Nr. 17/2016 për ndryshimin e Rregullores Nr. 14/2016, për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 09/2016 për Procedurat e Zgjedhjes, Emërimit, Vlerësimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës.

KGJK përmes kësaj rregullore ka eliminuar obligimin e përcaktuar me nenin 4, paragrafin 3 të Rregullores Nr. 14/2016, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores 09/2016 për Procedurat e Zgjedhjes, Emërimit, Vlerësimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës.

Respektivisht, sipas këtij Vendimi, iu është lejuar anëtarëve të Komisionit Vlerësues përveç të marrin pjesë në takimin e KGJK-së kur merret vendim për emërimin e Kryetarëve apo Gjykatësve Mbikëqyrës, të njëjtit të kenë edhe të drejtën për të votuar.

Përderisa, me Rregulloren Nr. 14/2016, të miratuar më 1 nëntor 2016, anëtarët e Komisionit Vlerësues kishin vetëm të drejtën për të marrë pjesë në takimin e Këshillit për Emërimin e Kryetarëve apo Gjykatësve Mbikëqyrës, pa të drejtë për të votuar.

Edhe përkundër faktit se KGJK këtë vendim e ka marr me qëllim të sigurimit të kuorumit për të vendosur lidhur me emërimin e Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjykatësve Mbikëqyrës, IKD vlerëson se praktikat e ndërtuara nga KGJK për të plotësuar dhe ndryshuar rregullat dhe procedurat disa herë gjatë procesit të përzgjedhjes ndikojnë në humbjen e besimit të publikut, qytetarëve dhe kandidatëve për këto pozita lidhur me një proces të drejtë, të paanshëm, të pavarur dhe profesional.

KGJK para miratimit të rregulloreve dhe akteve të brendshme të KGJK-së duhet të ketë qasje më serioze lidhur me planifikimin dhe vlerësimin e rrezikut gjatë procesit të vendim marrjes.

KGJK tanimë e ka shndërruar në praktik plotësimin dhe ndryshimin e rregullave dhe procedurave lidhur me procese të rëndësishme në sistemin gjyqësor. KGJK të njëjtin qasje kishte zbatuar edhe gjatë procesit të emërimit të gjykatësve të rinj.

Kuvendi i Republikës së Kosovës në maj të vitit 2015 ka miratuar plotësim ndryshimin e pakos së ligjeve të gjyqësorit, me qëllim të harmonizimit të dispozitave ligjore në mes këtyre ligjeve që ndërlidhet me procesin e emërimit, ri-emërimit, transferimit, disiplinimit dhe shkarkimit të

gjykatësve dhe prokurorëve dhe dispozitave tjera. Harmonizimi i dispozitave të këtyre ligjeve ishte caktuar kriter që duhej plotësuar nga Kosova lidhur me procesin e liberalizimit të vizave dhe Marrëveshjes për Stabilizim Asociim mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Edhe përkundër faktit që Kosova kishte arritur që të plotësoj këtë kriter përmes miratimit të pakos së ligjeve, në praktikë gjatë miratimit të akteve dhe politikave të brendshme, Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial është duke devijuar këtë rrugë, duke aplikuar praktika dhe standarde të ndryshme, lidhur me procese të njëjta. Përderisa, KPK ka përcaktuar se anëtarët e KPK që janë pjesë e komisionit vlerësues për Kryeprokurorë, nuk mund të marrin pjesë në votim në Këshill lidhur me këtë proces, KGJK ka aplikuar standard tjetër duke lejuar që anëtarët e Komisionit Vlerësues për Kryetar të Gjykatave të kenë të drejtën edhe të votimit në KGJK.

Rekomandim

KGJK duhet të ndaloj praktikat e deritanishme, ku brenda një viti miraton, plotëson dhe ndryshon të njëjtat rregullore disa herë.